

# Roli i rinisë për ndryshim social

## Hartëzimi i organizatave që punojnë me rini në Pejë

**Autorë:** Dorina Davies  
Dorina Glllogjani  
Errisa Hasimja

**Donatorë:**



Ky projekt përkrahet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe implementohet nga organizata George Williams Youth Association in Kosovo. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të George Williams Youth Association in Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS .

**Qershor, 2019**

|                                                                                                     |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Hyrje .....</b>                                                                                  | <b>4</b>  |
| <b>Kush është organizata George Williams Youth Association in Kosovo dhe me çfarë merremi .....</b> | <b>4</b>  |
| <b>1. Sfondi .....</b>                                                                              | <b>5</b>  |
| Qëllimi dhe objektivat e hartezimit .....                                                           | 5         |
| Metodologjia dhe mostra .....                                                                       | 5         |
| <b>2. Gjetjet .....</b>                                                                             | <b>6</b>  |
| Kufizimet metodologjike .....                                                                       | 12        |
| Rekomandime .....                                                                                   | 12        |
| Organizatat që kanë marrë pjesë në hartëzim.....                                                    | 13        |
| <b>3. Referencat e dokumentit .....</b>                                                             | <b>16</b> |

## Hyrje

Hartëzimi i organizatave aktive në Komunën e Pejës është një raport që ofron një pasqyrë të qartë të ambientit në të cilin ndodhen organizatat rinore dhe të cilat po i ndërlidhin aktivitetet e tyre me rininë apo i përfshijnë të rinjtë dhe të rejtat në to.

Ky hartëzim është kryer në kuadër të projektit “Roli i rinisë për ndryshim social” i cili është i mbështetur financiarisht nga KFOS - Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe është implementuar nga organizata George Williams Youth Association in Kosovo.

## ***Kush është organizata George Williams Youth Association in Kosovo dhe me çfarë merremi ?***

George Williams Youth Association in Kosovo është organizatë jo qeveritare dhe është përfaqësuese direkt e YMCA Botës me akronim GWY. GWY është organizatë e bazuar në vlerat e vullnetarizmit, që për qëllim ka inspirimin dhe inkurajimin e udhëheqjes tek të rinjtë dhe të rejtat, si dhe asiston në një ambient të shëndetshëm të komunitetit.

Vizioni ynë për Kosovë është të bëhemi një organizatë e fortë dhe kredibile e cila punon në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu të ndërtojmë liderë të së tashmes dhe të së ardhmes duke investuar në fuqizimin e rinisë si dhe të promovojmë paqe dhe unitet duke manifestuar diferencat dhe diversitetin e të tjerëve.

Zyra jonë nacionale për Kosovë është në Gjakovë. Për momentin punojmë në Komunën e Gjakovës, Pejës, Junikut, Deçanit, Prishtinës dhe kemi më tepër se 600 përfitues direkt që janë pjesëtarë aktiv në aktivitete javore në programet tona. Në mënyrë indirekte për dy vitet e fundit kemi arritur rreth 40 000 persona të shoqërisë sonë, duke e llogaritur ndikimin e pjesëmarrësve aktiv dhe vetëdijesimin e shoqërisë në bazë të kampanjave dhe programeve të ndryshme.

Punojmë me grupmosha prej 14 vjeç deri në 24 vjeç. Kemi programe të ndryshme si: Programi i “Lidershipit”, Programi “Y WoMan”, “YMCA Scouts”, “TenSing”, Programi i punësimit dhe trajnimit në YMCA England dhe Y USA, Change Agents, kemi edhe programe të trajnimeve ndërkombëtare me afat më të shkurt nëpërmjet Erasmus+ me ç’rast po thuhet se çdo vit dërgojmë afër 50-60 të rinj/reja në shtete të ndryshme të Evropës.

Një ndër programet tona kryesore është edhe Qendra e Edukimit jo-formal për Rini “Camp Pjetershan” e cila është duke u ndërtuar në fshatin Pjetërshan në Komunën e Gjakovës, e para e këtij lloji në Ballkanin Perëndimor.

GWY nga viti 2016 është anëtarë me të drejta të plota në YMCA Evropë ku përfaqëson Republikën e Kosovës. Për momentin YMCA ndodhet në 119 shtete dhe ka mbi 65 Milion pjesëmarrës aktivë çdo vit.

Për më shumë informacione rreth organizatës vizitoni web faqen tonë:

<https://www.ymcacosovo.com/>

## **1. Sfondi**

Ky hartëzim u realizua nga stafi i projektit “Roli i rinisë në ndryshimin social” nga organizata George Williams Youth Association in Kosovo.

Mjedisi dinamik i organizatave të shoqërisë civile kërkon përpjekje të vazhdueshme për t’i ruajtur dhe për t’i përditësuar veprimat e tyre, dhe aftësinë e tyre për t’u marrë me sfidat me të cilat këto organizata ballafaqohen në baza ditore. Për më tepër, ky mjedis kërkon përmirësime sistemore dhe ndryshime politike/legjislative të infrastrukturës ekzistuese për të krijuar mjedis më të favorshëm për aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile.

Realizimi i këtij hartëzimi ka ardhur nga nevoja e rifreskimit dhe e informimit korrekt për organizatat që punojnë vazhdimisht për ose me rininë, nevojë kjo e të rinjve dhe të rejave dhe institucioneve të ndryshme që të informohen për këto OJQ të cilat nuk e kanë pasur këtë lloj dokumenti më parë.

### **1.1 Qëllimi dhe objektivat e hartëzimit**

Hartëzimi është një mjet planifikimi dhe menaxhimi që vizualisht përshkruan rrjedhën e punës. Hartëzimet tregojnë një sërë ngjarjesh që prodhojnë një rezultat përfundimtar. Një hartë procesi quhet gjithashtu një diagramë rrjedhimi, diagrami i procesit, skema e proceseve funksionale, diagrami i rrjedhës funksionale, modeli i procesit, diagrami i rrjedhës së punës, diagrami i rrjedhës së biznesit ose diagrami i rrjedhës së procesit. Tregon se kush dhe çka është përfshirë në një proces dhe mund të përdoret në çdo biznes apo organizatë dhe mund të zbulojë fushat ku një proces duhet përmirësuar.

Qëllimi i hartës së proceseve është që organizatat dhe bizneset të përmirësojnë efikasitetin. Hartëzimet ofrojnë njohuri për një proces, ndihmojnë ekipet të mendojnë ide për përmirësimin e procesit, rritin komunikimin dhe sigurojnë dokumentacionin e procesit. Hartimi i procesit do të identifikojë pengesat, përsëritjen dhe vonesat. Ato ndihmojnë për të përcaktuar kufijtë e procesit, procesin e pronësisë, përgjegjësitë e procesit, dhe masat e efektivitetit.

Në vija të trasha, ky hartëzim do të shërbejë për të pasqyruar punën dhe kontributin e organizatave aktive për të rinjtë dhe të rejat e Komunes së Pejës.

### **1.2 Metodologjia dhe mostra**

Procesi i këtij hartëzimi ka zgjatur rreth dy muaj, ka filluar punimet nga muaji Shkurt dhe ka vazhduar punimet deri në muajin Prill.

Organizatat e synuara, për sa i takon madhësisë, përvojës, sektorëve të mbuluar, temave dhe prioritetëve, kanë një përbërje mjaft të llojllojshme.

Mostra e përdorur në këtë hartëzim ka qenë e qëllimshme, prandaj fillimisht janë targetuar organizatat që janë të regjistruara si organizata rinore në databazën e OJQ-ve të MAPL-së. Të gjitha organizatat e regjistruara me bazë në Pejë dhe Gjakovë janë kontaktuar me anë të emailit dhe

telefonit të paraqitura në databazën e OJQ-ve. Duke qenë se informatat e dhëna në këtë databazë janë shumë të vjetra dhe nuk janë rifreskuar ka pasur shumë organizata të cilat nuk janë përgjigjur me anë të email-it apo telefonit, kjo për arsye që disa prej tyre nuk janë më aktive. Prandaj në këtë formë është bërë një mënyrë e selektimit të organizatave që janë aktive dhe funksionojnë vazhdimisht.

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij hartëzimi është përmes anketës e cila është realizuar në dy forma, intervistimi i drejtëpërdrejtë dhe plotësimi i anketës në mënyrë elektronike. Kjo përzgjedhje është bërë duke marrë parasysh faktin që të gjitha organizatat janë aktive dhe kanë agjenda të ngjeshura me aktivitete.

Në procesin e hartëzimit janë përfshirë aktivisht 21 organizata nga Komuna e Pejës dhe Gjakovës, prej tyre 11 organizata nga Peja dhe 10 organizata nga Gjakova. Këto organizata kanë qenë shumë transparente dhe janë treguar shumë bashkëpunues në lidhje me projektin e “Rolit të rinisë për ndryshimin social”.


## 2. Gjetjet

Të dhënat nga databaza e OJQ-ve të MAPL tregojnë që nga viti 2008 në Komunën e Pejës janë të regjistruara 545 organizata. Por një numër i konsiderueshëm i këtyre organizatave nuk janë aktive apo të dhënat e tyre në këtë databazë nuk janë të sakta, kjo për disa arsye. Përderisa procesi i hapjes së organizatës është shumë i qartë dhe relativisht i lehtë, procesi i mbylljes së organizatës nuk është mjaftë mirë i sqaruar dhe kalon nëpër disa hapa.

Të vetmet raste kur aktiviteti/regjistrimi i një organizate u ndërpre (dhe më vonë u mbyll) kishte të bënte me organizata të cilat dyshoheshin për lidhje me ekstremizëm të dhunshëm dhe grupe radikale\*, dhe me organizata të cilat rrezikonin rendin kushtetues në Kosovë \*\*. Përveç këtyre, nuk ka të dhëna zyrtare për rastet e çregjistrimit të organizatave apo të shpërbërjes së tyre nga institucionet shtetërore.


Nuk ka dallim të qartë ndërmjet organizatave joaktive në databazën e OJQ-ve të regjistruara, por dëshmitë nga burimet e tjera tregojnë se rreth një e treta e organizatave të regjistruara kanë marrë/kanë kërkuar fonde nga donatorë të ndryshëm dhe kanë qenë aktive rishtazi \*\*\*.

Të gjitha organizatat e regjistruara me bazë në Komunën e Pejës janë të regjistruara si shoqata lokale, përkatësisht 100%.



Grafiku i paraqitur më poshtë jep të dhëna të qarta duke pasqyruar kështu veprimtarinë kryesore të organizatave që kanë qenë pjesë e hartëzimit. Kështu mund të raportojmë që grafiku përmban fusha të ndryshme të aktiviteteve dhe fusha me përqindjen më të madhe, saktësisht rreth 20% e ka fusha e rinisë. Në rendin e dytë me përqindjen më të madhe vlersohet të jetë fusha e edukimit jo formal e cila ka 10%. Me të njëjtën përqindje është edhe pjesëmarrja sociale përkatësisht 10%. Më pas organizatat që merren me barazi gjinore dhe mjedisë kanë 8% të të gjithë grafikut.


Me nga 6% janë shfaqur fushat e veprimit si: të drejta të njeriut, pjesëmarrje qytetare, trashigimi kulturor, kulturë. Dhe në fund me nga 2% janë pasqyruar fushat e veprimit si: sipërmarrje sociale, migrim/refugjatë/riatdhesim, punësim, sundim i ligjit, ndihmë personave me nevoja të veçanta, fëmijë dhe komunitetet e marginalizuara, ndihmë akademike për studenta të komunitetit, mundësi dhe përgaditje për punësim, zhvillim i qëndrueshëm dhe barazi të komuniteteve. Pra me të dalurat përfundimtare të këtij grafikoni mund të themi se ojq-të e intervistuar punojnë më së shumti me rini.




Kurse nëse marrim si qështje disaktimi aktivitetet bazike që realizohen nga këto organizata pa mbështetje të donatorëve, OJQ-të u përgjigjën si më poshtë:

- Raportimi i fëmijëve (abuzimeve, etj), raportimi social (rrezikshmëria e lartë me substanca);
- Movie nights, game nights, music nights, kafe të debatit, trajnime profesionale të multi-medias, programimit, dizajnit grafik, kurse të baletit, kurse të vallëzimit, kurse të fotografisë;
- Panele të diskutimit, Bar Kampe, Shfaqje të filmave si dhe diskutime pasuese;
- Aktivitete të riciklimit të mbetjeve elektronike dhe kthimi i tyre në robot;
- Trajnime të Shkathtësive të buta;
- Aktivitete organizative të pastrimit të hapësirave publike, mbjellja e findaneve apo zhvillimi i gjelbërimit;
- Programi i Leadershipit, scouts, programi për barazi gjinore, Dyqani i Bamirësisë, programi i artit, etj. ;
- Takimet e rregullta me staf dhe vullnetarët, hulumtime online dhe pyetësor;
- Lobimi/Avokimi mjedisor Organizimi i ngjarjeve të karakterit vullnetar;
- Si dhe disa organizata kanë potencuar që ata nuk i zhvillojnë apo vazhdojnë aktivitetet kur nuk kanë fonde nga donatorët.

Për sa i përket vitit të regjistrimit të organizatave të intervistuar, disa prej tyre kanë pranuar që kanë nisur veprimtarin e tyre dhe më pas janë regjistruar. Pra, viti i themelimit të tyre ka qenë ndryshe nga viti i regjistrimit. Më posht mund të shikoni se në cilat vite janë regjistruar këto institucione.




Tani, në grafikonin e më poshtëm mund të shihni se cili është numri i stafit të punësuar në këto organizata. Duke marr parasysh që stafi shumicën e herëve mund të ketë qenë i paguar nga fondet dhe projektet të cilat janë jap nga donatorët dhe partnerët e këtyre organizatave.




Në sektorin e organizatave jo qeveritare puna vullnetare vlerësohet shumë sepse e ndihmon zhvillimin dhe implementimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme që organizatat në fjalë i kanë. Në figurën e radhës ne kemi pyetur organizatat se cili është numri i vullnetarëve aktiv gjatë vitit 2018. Me më së shumti përqindje mund të shohim numrat 19% dhe 18%, pra me 0 vullnetarë


edhe 20 vullnetarë, duke nënkuptuar se disa organizata i zhvillojnë aktivitetet e tyre pa asnjë vullnetarë, pra nuk ju duhet ndihmave nga ta apo kanë mjaftueshëm staf të cilët e mbulojnë hapësirën e lire për vullnetarët. Kurse pjesa tjetër varijon me nga 9% të cilët kanë 3, 8, 16, 21, 34, 50 dhe 80 vullnetarë të cilët kanë qenë aktiv gjatë gjithë vitit 2018.




Në pyetësin tonë kemi përfshirë edhe pjesën financiare të të hyrave vjetore për vitin 2018 të secilës nga organizatat ku kemi marr të dhënat që mund ti shihni më poshtë. Ato kanë treguar qartë se me 28% kemi organizata të cilat kanë të hyra vjetore me më pak se 10 000 EUR në vit. Kurse me një diferencë shumë të vogël, pra 27% kemi organizata të cilat qarkullojnë me 50 000-100 000 EUR në vit. Por kemi edhe organizata që kanë deklaruar që kanë më pak se 5 000 EUR të hyra vjetore. Përfaqësuesit e të tjerave nuk kanë pasur informacione lidhur me këtë, ose kanë qarkullim vjetor me 10 000-25 000 EUR në vit ose me mbi 100 000 EUR në vit, këto kategori i kanë secila nga 9% të grafikunit.



Burimi financiarë të organizatave është i paraqitur në grafikun më poshtë. Mund të theksojmë se disa nga përgjigjet janë bashkangjitur edhe me komentin e vështirësive të gjetjes së fondeve të vazhdueshme, pasi që në shumicën e rasteve fondet kanë qenë më pak se një vit. Por, më poshtë mund të shihni se cilat kanë qenë këto burime.



Për sa i përket operimit dhe hapësirave të cilat OJQ-të, sipas përgjigjeve që kemi mbledhur, më shumë se shumica prej tyre pohojnë se kanë hapësira, këtë e kemi paraqitur më poshtë:



## **2.1 Kufizimet metodologjike**

Gjatë realizimit të këtij hartëzimi njëri ndër kufizimet më të mëdha ka qenë numri i vogël i organizatave aktive që punojnë me rini në Komunën e Pejës ndërsa organizatat tjera të cilat janë ende të hapura dhe të regjistruara si organizata rinore për shkak të mungesës së aktiviteteve dhe fondeve nuk kanë pranuar fare të përfshihen në proces. Për këtë arsye dhe duke u bazuar në faktin që shumë organizata tjera të cilat fokus kryesor të punës nuk e kanë punën me rini por zhvillojnë aktivitete dhe projekte me rininë në kemi përfshirë edhe këto organizata në hartëzim.

Kufizim tjetër i këtij hartëzimi mund të konsiderohet edhe fakti që duke qenë se është hera e parë që një publikim i tillë po realizohet në këtë rajon dhe për këtë sektor çdo gjë është krijuar për herë të parë dhe nuk kemi pasur asnjë pikë referente ku do të mund të bazoheshim.

## **2.2 Rekomandime**

Duke u bazuar në procesin e hartëzimit kanë dalur këto rekomandime:

1. Rekomandohet që organizatat të bëjnë në mënyrë të qartë dallimin në mes të përfituesve dhe vullnetarëve, duke qenë se ekziston një keqkuptim i OJQ-ve rinore sa i përket dallimit në mes të përfituesve nga aktivitetet e tyre dhe vullnetarëve.
2. Të fokusohen organizatat në sektorin e rinisë në ofrimin e programeve afatgjate për të rinjtë dhe të rejtat.
3. Organizatat duhet të bëjnë publik raportin vjetor, ku janë të përfshira aktivitetet dhe financat e tyre për vitin përkatës. Nëse organizatat nuk kanë webfaqe të tyre mund të përdorin rrjetet e tyre sociale.
4. Të fokusohen organizatat më shumë në qëndrueshmërinë financiare, në mënyrë që të mos jenë të varur vetëm nga fondet.
5. Nëse ende nuk janë regjistruar në Platformën e vullnetarëve inkurajojmë organizatat që kanë vullnetarë që ta bëjnë këtë në mënyrë që orët e tyre të llogariten edhe zyrtarisht.

### 2.3 Organizatat që kanë marrë pjesë në hartëzim



**Misioni i organizatës:**

Thyerja e apatisë së qytetarëve përmes aktiviteteve kulturore.

**Viti i themelimit:** 2010

**Përfaqësuesi:** Vullnet Sanaja

**Kontakti:** 00383 (0) 38 749 235, [www.anibar.org](http://www.anibar.org), [info@anibar.com](mailto:info@anibar.com)



**Misioni i organizatës:**

Vetëdijesimi i gjeneratave të reja dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit.

**Viti i themelimit:** 2003

**Përfaqësuesi:** Kreshnik Potoqani

**Kontakti:** 00383 (0) 44 337 601, [info@eradirect.org](mailto:info@eradirect.org), [niki\\_potoqani@live.com](mailto:niki_potoqani@live.com)



**Misioni i organizatës:**

Mbështetja e komunitetit përmes informimit, avokimit, vetëdijesimit, përmirësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të individëve të grupeve jo formale dhe komunitetit.

**Viti i themelimit:** 2009

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Vllaznim Krasniqi

**Kontakti:** 00383 (0) 49 809 580, [nismanpu.wordpress.com](http://nismanpu.wordpress.com); [nisma.npu@gmail.com](mailto:nisma.npu@gmail.com)



**Misioni i organizatës:**

Ngritja akademike e studentave të komuniteteve dhe plasimi i tyre në tregun e punës.

**Viti i themelimit:** 2016

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Fatmir Sykaj

**Kontakti:** 00383 (0) 49 268 800, [www.romaversitas.org](http://www.romaversitas.org); [fatmir@romaversitas.org](mailto:fatmir@romaversitas.org)



**Misioni i organizatës:**

Edukimi jo-formal i të rinjve dhe fuqizimi i rolit të të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

**Viti i themelimit:** 2016

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Vullnet Gusia

**Kontakti:** 00383 (0) 49 150 255, [yic.peja@gmail.com](mailto:yic.peja@gmail.com)



**Misioni i organizatës:**

Shtytja përpara e të rinjve në mënyrë që të jenë sa më aktiv që të fitojnë përvoja të ndryshme me trajnime.

**Viti i themelimit:** 2005

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Argjend Gorçaj

**Kontakti:** 00383 (0) 49 735 911, [kvrl.peje@gmail.com](mailto:kvrl.peje@gmail.com)



**Misioni i organizatës:**

Shtytja përpara e të rinjve në mënyrë që të jenë sa më aktiv që të fitojnë përvoja të ndryshme me trajnime.

**Viti i themelimit:** 2012

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Urim Xharavina

**Kontakti:** 00383 (0) 49 124 548, [letsdoitpeja@gmail.com](mailto:letsdoitpeja@gmail.com), [letsdoitpeja.org](http://letsdoitpeja.org)



**Misioni i organizatës:** Ngritja e diturisë profesionale tek të rinjët dhe të rejtat në të gjitha drejtimet, kombësitë, fetë, etj. Si dhe ngritja e kapaciteteve kulturore, ekonomike, zhvillimin e të rinjëve, duke kryer edhe hulumtime kombëtare historike.

**Viti i themelimit:** 2014

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Faruk Daci

**Kontakti:** 00383 (0) 45 637 107, [gendrafd@gmail.com](mailto:gendrafd@gmail.com)



**Misioni i organizatës:** Edukimi i rinisë, pa dallime etnike, fetare, gjinore. Ndhimesa e shoqërisë që të angazhohen në integrim dhe zhvillim të komunitetit.

**Viti i themelimit:** 2010

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Sebastian Merdita

**Kontakti:** 00383 (0) 49 889 876, [fizh.rks@gmail.com](mailto:fizh.rks@gmail.com)



**Misioni i organizatës:** Organizate lokale mjedisore e cila tenton që përmes adresimit të problemeve mjedisore t'i vendosë në ndërpim komunitetet e ndara.

**Viti i themelimit:** 2011

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Granit Gashi

**Kontakti:** 00383 (0) 49 433 395, [infotheparkfest@gmail.com](mailto:infotheparkfest@gmail.com)



**Misioni i organizatës:** Të jemi një lëvizje gjithëpërfshirëse ku njerzit zhvillohen në mendje, trup dhe shpirt.

**Viti i themelimit:** 2013

**Përfaqësuesi i autorizuar:** Dorina Davies

**Kontakti:** 00383 (0) 45 695 429, [office@gwykosovo.com](mailto:office@gwykosovo.com)

### 3. Referencat

\*OJQ-të të cilat promovojnë ekstremizmin nuk janë të lejuara të veprojnë. Radion Free Europe/Radion Liberty, <https://www.evropaelire.org/a27550186.html>

\*\*Ministria e Administratës Publike. DOJQ. Vendimi 06/097/2017 për suspendimin e aktivitetit të Airsoft Club Kodiak. [https://map.rksgov.net/getattachment/4705fd74-a4cd-4518-9644-afa12f0ee875/Vendim-\(1\).aspx](https://map.rksgov.net/getattachment/4705fd74-a4cd-4518-9644-afa12f0ee875/Vendim-(1).aspx) dhe Vendimi 06/096/2017 për suspendimin e aktivitetit të Airsoft Club Vukovi. <https://map.rks-gov.net/getattachment/feff1b4f-6a69-4c84-95d0-3d6c95fd45de/Vendim.aspx>

\*\*\*<https://grasks.com/wp-content/uploads/2018/09/Final-report-shqip.pdf>